

Në bazë të nenit 18, paragrafi (1), nënparagrafi 20 dhe neni 23, paragrafi (1), nënparagrafi 1 të Ligjit të Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr.42/20, 77/21, 154/23, 55/24 dhe 193/24, dhe në lidhje me nenin 50, paragrafi (3) nga Ligji i njëjtë dhe nenet 20 dhe 21 të Rregullores për mbrojtjen e të miturve ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.172/14), pika 6 dhe pika 14 e Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrje të masës (Tekst i pastruar) ark.nr.01-4139/1 datë 07.11.2022, Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore ark.nr.10-4125/1 datë 04.10.2024 dhe Konkluzionin ark.nr.02-4644/14 datë 18.11.2024, Këshilli i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, në seancën e 42-të mbajtur më 15.11.2024, miratoi si vijon:

### **Aktvendimin për ndërmarrjen e masës - paralajmërim publik**

PUBLIKISHT PARALAJMËROHET Shoqëria Tregtare Radiodifuzive (SHTR) KOMPANI 21-M SHPKNJP Shkup, për shkeljen e kryer të nenit 50, paragrafi (3) të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale (LSHMAAV) dhe neneve 20 dhe 21 të Rregullores për mbrojtjen e të miturve (RRMPM), të mënyrës që në shërbimin programor televiziv të radiodifuzerit, transmetuar më 5 shtator 2024, episodet premierë dhe reprizat e serialit të shfaqur "I egri (Yabani)" dhe episodi premierë i serialit të shfaqur "Jetë të thyera (Kırık hayatlar)" u transmetuan me aplikim të gabuar të sinjalit paralajmërues për programin e kategorisë së dytë (8+). Para fillimit të transmetimit të episodeve të tërësisë së pamjes së parashikuar me ligj të sinjalistikës paralajmëruese të aplikuar për program të klasifikuar në kategorinë e dytë, mungon *numri "8"* dhe *shenja "+"*, si tregues të grupmoshës së shikuesve për të cilin është destinuar programi.

Shkelja nga paragrafi (1) i kësaj pike, është specifikuar dhe në Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore ark.nr.10-4125/1 datë 04.10.2024, që është pjesë përbërëse e këtij Aktvendimi si Shtojcë nr.1.

2. URDHËROHET SHTR KOMPANI 21-M SHPKNJP Shkup që në afat prej 20 (njëzet) ditësh nga dita e pranimit të këtij Aktvendimi ta harmonizojë punën e saj me dispozitat e ZLSHMAAV dhe RRMPM.

3. Pas skadimit të afatit përcaktuar në pikën 2 të këtij Aktvendimi, të kryhet mbikëqyrje kontrolli, për të përcaktuar nëse subjekti i mbikëqyrjes, i cekur në pikën 1 të këtij Aktvendimi, ka vepruar sipas Aktvendimit.

4. Ky Vendim është përfundimtar dhe dita e miratimit të tij konsiderohet dita e çertifikimit në arkivin e Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale (Agjencia).

### **A r s y e t i m**

Agjencia në bazë të nenit 28 të LSHMAAV është kompetente për të kryer mbikëqyrje programore (monitorim) të programeve të radiodifuzerëve dhe ofruesve të shërbimeve mediatike audiovizuale me kërkesë, si dhe të paketave programore që ritransmetohen nga operatorët e rrjetit publik të komunikimit elektronik nga aspekti i respektimit të dispozitave nga Ligji i cituar, Çertifikatave të dhëna për regjistrim, aktet nënligjore dhe akte të tjera të miratuara nga Agjencia.

Në pajtim me nenin 23, paragrafi (1), nënparagrafi 1 të LSHMAAV, Këshilli i Agjencisë kundër botuesit të medias (transmetuesit) ndërmerr masë-paralajmërim publik në rastet kur ka cënim ose

shkelje të dispozitave të LSHMAAV dhe aktet nënligjore të miratuara në bazë të Ligjit të njëjtë, si dhe kushtet dhe detyrimet e përcaktuara me lejen dhe aktet e tjera të Agjencisë.

Në pajtim me nenin 50, paragrafi (1) të LSHMAAV, radiodifuzeri nuk duhet të transmetojnë ose transmetojnë programe që mund seriozisht të dëmtojnë zhvillimin fizik, mendor ose moral të të miturve, në veçanti programe që përmbajnë pornografi ose dhunë të tepruar. Ofruesit e shërbimeve, me kërkesë, duhet të ndërmarrin masat teknike më të rrepta për të siguruar që të miturit të mbrohen nga përmbajtja më e dëmshme si dhuna e tepruar dhe pornografia. Përveç programeve nga paragrafi (1) i këtij neni, programe të tjera që mund të dëmtojnë zhvillimin fizik, mendor ose moral të të miturve, sigurohen nga ofruesit e shërbimeve mediatike audiovizuale në mënyrë që të miturit të mos mund t'i shohin në mënyrën e zakonshme ose të dëgjojnë programet. Kur programet transmetohen ose reprizohen në formë të pakoduar, ofruesi i shërbimeve mediatike audiovizuale është i detyruar që përpara transmetimit të tyre të siguron paraprakisht paralajmërim akustik dhe mundësinë për t'u njohur me ndihmën e shenjave vizuale gjatë gjithë transmetimit të programeve (neni 50 paragrafi 3 i LSHMAAV).

Në nenin 20 të RRMPM është parashikuar mënyra e aplikimit të sinjalistikës paralajmëruese. Në pajtim me paragrafin (1) të nenit të njëjtë para fillimit të programeve televizive përfshirë me nenin 19 të Rregullores (Programet në të cilat aplikohet sinjalizimi paralajmëruar), detyrueshëm transmetohet sinjal paralajmëruar që korrespondon me kategorinë e programit dhe është kombinim i shenjës vizuale, tekstit, verbale dhe paralajmërim akustik, vazhdon së paku 10 sekonda dhe mbulon së paku 1/4 e pjesës së dukshme të ekranit. Gjatë programeve televizive që përfshin neni 19 i Rregullores, vazhdimisht transmetohet vetëm shenja vizuale nga sinjali paralajmëruar, që aplikohet me dimenzion prej 1/32 në kënd të dukshëm të pjesës së ekranit. Përjashtohen shenjat vizuale për programe televizive me teknika hipnotizuese dhe me dridhje drite, që aplikohen në ekran pas çdo pauze për reklamimi (paragrafi 2).

Në nenin 21 të RRMPM (Pamja dhe përmbajtja e sinjalistikës paralajmëruese), ndër të tjera, parashikohet që sinjalistika paralajmëruese që aplikohen para, deri ose gjatë programeve nga ofruesit e shërbimeve mediatike audiovizuale, për programet e klasifikuara në kategoria e dytë, duhet të qëndrojë numri "8" dhe shenja "+", si dhe tekstin e paralajmërimit: "Programe të kategorisë së dytë që nuk rekomandohen për fëmijët nën 8 vjeç. I domosdoshëm mbikëqyrja nga prindi ose kujdestari."

Në kuadër të kompetencave ligjore, Agjencia përmes Sektorit për çështje programore, më 4 tetor 2024, ka kryer mbikëqyrje të rregullt programore (monitorim) të shërbimit programor televiziv të SHTR KOMPANI 21-M SHPKNJP Shkup, transmetuar më 5 shtator 2024, në nivel shtetëror, ku është konstatuar shkelje të nenit 50, paragrafi (3) të LSHMAAV dhe neneve 20 dhe 21 të RRMPM.

Pikërisht, me monitorimin e rregullt programor mbi shërbimin programor televiziv të SHTR KOMPANI 21-M SHPKNJP Shkup, transmetuar më 5 shtator 2024, në nivel shtetëror, është konstatuar shkelje e nenit 50, paragrafi (3) i LSHMAAV dhe nenet 20 dhe 21 të RRMPM. Ndryshe nga nenet 20 dhe 21 të RRMPM, në shërbimin programor të datës 5 shtator 2024, me aplikim të gabuar të sinjalizimit për programin e kategorisë së dytë (8+), u transmetuan episode premierë dhe repriza të serialit artistik "I egri (Yabani)", dhe episodi premierë i serialit artistik "Jetë të thyera (Kirik haylatlar)". Gjegjësisht, para fillimit të transmetimit të episodeve të serialit artistik të lartpërmendur, në tërësi të pamjes së paraparë me ligj të sinjalit paralajmëruar të aplikuar për program të klasifikuar në kategorinë e dytë, mungojnë: numri "8." dhe shenja "+", si tregues të grupmoshës së shikuesve për të cilin destinohet programi.

Shkelja nga pika 1 e këtij Aktvendimi është specifikuar në Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore ark.nr.10-4125/1 datë 04.10.2024, që është pjesë përbërëse e këtij Aktvendimi si Shtojcë nr.1.

Në pajtim me nenin 23, paragrafi (3) të LSHMAAV, Këshilli i Agjencisë drejtuar SHTR KOMPANI 21-M SHPKNJP Shkup, me datë 08.10.2024, ka dërguar Shkresë me nr ynë.ark.10-4125/3 datë 08.10.2024, me të cilin i dorëzoi Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore, ark.nr.10-4125/1 datë 04.10.2024, me qëllim që në afat prej 7 (shtatë) ditë pune nga dita e pranimit të shkresës, drejtuar Këshillit të Agjencisë të dorëzon deklarament me shkrim për shkeljen e kryer të dispozitave të LSHMAAV dhe RRMPM. Shresa është pranuar në mënyrë të rregullt nga transmetuesi më datë 08.10.2024, për të cilën në afatin e përcaktuar SHTR KOMPANI 21-M SHPKNJP Shkup nuk ka paraqitur deklaratë me shkrim për shkeljen e kryer të dispozitave të LSHMAAV dhe RRMPM. Këshilli i Agjencisë, në seancën e 42-të mbajtur më 15.11.2024, e shqyrtoi lëndën Raport me shkrim dhe deklaratën e dorëzuar me shkrim dhe konstatoi që SHTR KOMPANI 21-M SHPKNJP Shkup t'i shqiptohet masë – vërejtje publike.

Rrjedhimisht nga sa mësipër, në bazë të nenit 18, paragrafi (1), nënparagrafi 20 dhe neni 23, paragrafi (1), nënparagrafi 1 të LSHMAAV, dhe në lidhje me nenin 50, paragrafi (3) të Ligjit të njëjtë dhe neneve 20 dhe 21 të RRMPM, pika 6 dhe pika 14 e Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrjen e masës (Tekst i pastuar), Raporti me shkrim për mbikëqyrjen e kryer programore ark.nr.10-4125/1 datë 04.10.2024 dhe Konkluzionin ark.nr.02-4644/14 datë 18.11.2024, për konstatim të mos respektimit të dispozitave të LSHMAAV dhe RRMPM, përcaktuar në pikën 1 të këtij Aktvendimi, Këshilli i Agjencisë në seancën e 42-të mbajtur më 15.11.2024, miratoi Aktvendimin me të cilin publikisht paralajmëron SHTR KOMPANI 21-M SHPKNJP Shkup dhe e urdhërohet që në afat prej 20 (njëzet) ditësh nga dita e pranimi të Aktvendimit, ta harmonizojë punën e saj me dispozitat e LSHMAAV dhe RRMPM. Pas skadimit të afatit të përcaktuar në pikën 2 të këtij aktvendimi, të kryhet mbikëqyrje kontrolli, për të përcaktuar nëse subjekti i mbikëqyrjes, i cekur në pikën 1 të këtij Aktvendimi, ka vepruar sipas Aktvendimit.

Në pajtim me nenin 24 të LSHMAAV, ky Aktvendim është përfundimtar dhe kundër këtij aktvendimi radiodifuzeri ka të drejtë padie për ngritje të kontestit administrativ para gjykatës kompetente. Padia për ngritjen e kontestit administrativ paraqitet në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimi të aktvendimit.

Bazuar në sa më sipër u miratua aktvendim si në dispozitiv.

**Shtojcë (1):**

- 1) Raport me shkrim për mbikëqyrjen e kryer programore ark.nr.10-4125/1 datë 04.10.2024.

**Agjencia për Shërbime Mediatike  
Audio dhe Audiovizuele  
Kryetari i Këshillit,  
Lazo PETRUSHEVSKI, d.v.**

**Këshillë juridike:** Kundër këtij aktvendimi radiodifuzeri ka të drejtë padie për ngritje të kontestit administrativ para gjykatës kompetente. Padia për ngritjen e kontestit administrativ paraqitet në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimi të aktvendimit.